

VENDIM
Nr. 169, datë 25.2.2015

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE, PJESE TË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante, të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2015, është, gjithsej, 760, ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- | | |
|---|------|
| a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) | 30; |
| b) Për kategorinë e mesme drejtuese | 40; |
| c) Për kategorinë e ulët drejtuese | 180; |
| ç) Për kategorinë ekzekutive | 510. |

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë:

- Shkenca Juridike;
- Shkenca Kompjuterike;
- Audit i Brendshëm;
- Shkenca Ekonomike;
- Shkenca Shoqërore;
- Shkenca Sociale;
- Histori-Filologji;
- Teologji;
- Shkenca Mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Inxhinieri;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e Bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca Ekzakte;
- Shkenca Edukimi;
- Mësuesi;
- Arsimit i Lartë Ushtarak/policor.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2015, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit

1. Kryeministria
2. Agjencia Telegrafike Shqiptare
3. Komisioni i Prokurimit Publik
4. Akademia e Shkencave
5. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
6. Instituti i Statistikave në nivel qendror dhe rajonal
7. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
8. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
9. Departamenti i Administratës Publike
10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në nivel qendror dhe rajonal
12. Inspektorati Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit dhe Ujërave në nivel qendror dhe rajonal
13. Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes
14. Aparati i Ministrisë së Kulturës
15. Aparati i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
16. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal
17. Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal
18. Aparati i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë
19. Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave
20. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
21. Aparati i Ministrisë së Integritetit Evropian
22. Aparati i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës
23. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
24. Autoriteti i Aviacionit Civil
25. Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore
26. Autoriteti Rrugor Shqiptar në nivel qendror dhe rajonal
27. Drejtoria e Përgjithshme Detare në nivel rajonal
28. Aparati i Ministrisë së Punëve të Jashtme
29. Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë
30. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
31. Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
32. Aparati i Ministrisë së Drejtësisë
33. Komiteti Shqiptar i Birësimeve
34. Instituti i Mjekësisë Ligjore
35. Aparati i Ministrisë së Zhvillimit Urban
36. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
37. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
38. Agjencia Kombëtare e Turizmit
39. Zyra e Shërbimit Turistik në nivel qendror dhe rajonal
40. Agjencia Kombëtare e Bregdetit në nivel qendror dhe rajonal
41. Aparati i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
42. Qendra Kombëtare e Licencimit
43. Agjencia e Trajtimit të Konkencioneve
44. Agjencia Shtetërore e Zhvillimit të Investimeve
45. Qendra Kombëtare e Regjistrimit
46. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në nivel qendror dhe rajonal

47. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
48. Aparati i Ministrisë së Financave
49. Degë Thesari në nivel vendor
50. Agjencia e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
51. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
52. Tatimpaguesit e Mëdhenj Tiranë
53. Drejtoritë rajonale tatimore
54. Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore-Doganore
55. Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
56. Zyrat arsimore rajonale
57. Drejtoritë arsimore rajonale
58. Aparati i Ministrisë së Punëve të Brendshme
59. Policia e Shtetit
60. Prefekturat
61. Nënprefekturat
62. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
63. Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve
64. Drejtoritë e Bujqësisë në nivel vendor
65. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në nivel qendror dhe rajonal